



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

04NR. 030-16740 /2022

Klinë, 23.05.2022

KONTRATA NR. 3/2022 DCA

KOMUNA KLINË (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, nenit 19, Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar, pika 4, kontrata me vlerë minimale, që përfaqësohet nga drejtoresha e Çerdhës së fëmijëve "Xhevë Lldrovci" në Klinë, znj.Bojlje Fejza, në njërën anë;

Dhe

N.T."BUJAR LEKTRONICS" (emri tregtar) me emër të biznesit "Bujar Dakaj" B.I. (në vazhdim "Furnizuesi"), me adresë - KLINË NR. UNIFIKUES 811248261 të cilën e përfaqëson Granit Kalludra, në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizimet e shënuara më poshtë:

"FURNIZIM ME LAVATRIQE DHE PAJISJE TJERA NË ÇERDHËN E FËMIJËVE, KLINË"

me numër identifikues:634-22-47-147

Neni 1

Lënda

Lënda e kontratës do të jetë FURNIZIM – **"FURNIZIM ME LAVATRIQE DHE PAJISJE TJERA NË ÇERDHËN E FËMIJËVE, KLINË"** nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

III.1) PËRSHKRIMI I OBJEKTIT TË KONTRATËS:

Artikull	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi- (duke përfshirë gjitha taksat etj)	Cmimi Total -
1	Sipas specifikacionit të bashkëngjitur .	cope	1	985.00	985.00
				Totali i	985.00

1.2. Sipas karakteristikave të dhëna në ofertën financiare të bashkëngjitur në këtë kontratë

Neni 2

Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë– 2 DY DITË nga koha e nënshkrimit të kontratës .

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë NE VENDET E CAKTUARA NGA ORGANIZATORI – Klinë

2.3 Inkotermi I zbatueshëm do të jetët DDP –KLINË.

Neni 3

Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4

Çmimi

4.1 Çmimi total I furnizimeve duhet të jetë: **985.00 €.**

DDP (të gjitha të përfshira në çmim (dogana, taksa lineare dhe TVSH)

(TREQIND E TETËDHJETË E PESË EURO).

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 .Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

4.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës. Pagesa do te behet siq vijon: **Me të pranuar të mallit me faturë dhe Fletëdorëzim-fletëpranim .**

Neni 5

Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paçartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6

Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin

e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shënohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.



6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Menagjimin e kontratës në bazë të Nenit 81 të LPP 05/L-068 do ta bëjë


DREJTORESHA E ÇERDHËS SË FËMIJËVE "XHEVË LLADROVCI", KLINË - Bojlije Fejza

Për Furnizuesin
N.T.T."BUJAR ELECTRONICS"

Për Autoritetin Kontraktues
DREJTORESHA E ÇERDHËS SË FËMIJËVE
"XHEVË LLADROVCI", KLINË

Emri:	BUJAR DAKAJ	Emri:	BOJLIJE FEJZA
Pozita:	DREJTOR	Pozita:	DREJTORESHË
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	22.05.2022
Vula:		Vula:	

Per





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

www.komuna-kline.org

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



PARAMASA: FURNIZIM ME LAVATRIÇE DHE PAJISJE TJERA NË ÇERDHËN E FËMIJËVE, KLINË

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Qmimi	Totali
1	Furnizim, montim i lavatriçes me kapacitet 9 kg, shpejtësia e centrifugës 1200, dimensionet (80x60x60)cm.	copë	1	350	350
2	Furnizim, montim Aspirator në kuzhinë	copë	1	95	95
3	Fshesë elektrike 2400v	copë	1	70	70
4	Fshesë elektrike 1600v	copë	1	30	30
5	Furnizim, montim Klimë 12 inverter	copë	1	440	440
TOTALI					985 ⁰⁰

Nënshkrimi, vula